



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2807/2 Prot.

Elbasan, më 26.06.2024

VENDIM

Nr. 58 datë 10.06.2024

“Për miratimin e nismës së rishikimit të Dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor me Procedurë të Thjeshtuar, Bashkia Elbasan”

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 10.06.2024, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit “Për miratimin e nismës së Rishikimit të Dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor me Procedurë të Thjeshtuar”, mbështetur në:

- Ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”,
- Ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar,
- VKM nr. 686, datë 22.11.2017, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar,
- VKM nr. 881, datë 14.12.2016, “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit”,
- Udhëzim i AKPT nr.1, datë 22.02.2019, “Për hartimin bashkërendimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumentave të Planeve të Përgjithshme Vendore me procedurë të thjeshtuar”,

VENDOSI:

1. Të miratojë nismën e rishikimit të Dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor me Procedurë të Thjeshtuar, Bashkia Elbasan.
2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për mbarëvajtjen e procesit deri në miratimin dhe zbardhjen e PPV-së së rishikuar, sipas detyrimit ligjor.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi:
Përgjegjësi i SKTL:
A. Muhametaj
Drejtori i DPZHT:
Miratoi:
Drejtori i DPSH^O:
D. Meta
Konfirmoi:
Zv/Kryetari:
A. Sula

D. Hasa
A. Muhametaj
D. Meta
A. Sula

SEKRETARI
Elvi Çuni

KRYETAR
Lutfi Lala

REPUBLICA ALBANA - KOMUNITETI I KUQEJVE PËR RASHKIA ELBASANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KRYETARI



Nr. 280 Prot

Elbasan me 03/06/2024

VENDIM

Nr. 596, Datë 03.06.2024

“PËR

**NDËRMARRJEN E NISMËS PËR RISHIKIMIN E DOKUMENTIT TË
 PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR, BASHKIA ELBASAN ME PROCEDURË TË
 THJESHTUAR”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, në nenin 13, pika 1, shkronja “b”, në nenin 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, në nenin 11 dhe 12 të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, e ndryshuar, Kryetari i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të ndërmarrë nismën për rishikimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor me procedurë të thjeshtuar, për ato çështje dhe kërkesa të cilat:
 - a. Janë në perputhje dhe nuk bien në kundërshtim me legjisacionin sektorial në fushën e mjedisit, zonave te mbrojtura, trashegimine historike e kulturore;
 - b. Janë në përputhje, nuk bien në kundërshtim dhe nuk ndryshojne dokumentin e Strategjisë Territoriale;
 - c. Vijnë si pasojë e konstatimit të gabimeve e mosperputhjeve në dokumentin e Planit dhe mes pjesëve përbërëse të tij, si edhe mes Planit e gjendjes faktike në territor;
 - d. Vijnë si pasojë e forcave madhore, si: tërmete, përmbytje, zjarre masive, rrëshqitje të tokës, erozion, etj., të ngashme, për shkak të ndarjeve administrative e territoriale, ndryshimeve te paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshimeve të shkaktuara nga kriza sektoriale;
 - e. Vijnë si nevoje për harmonizimin me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes



menaxhimit të territorit, si dhe per arsyet e përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

2. Pjesë integrale e këtij vendimi është dokumenti i nismës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Elbasan.
4. Vendimi për miratimin e Nismës dhe dokumenti i Nismës botohen në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e miratimit.

K R Y E T A R I

Z. GLEDIAN LLATJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

NISMA

PËR RISHIKIMIN E
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA ELBASAN



TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	3
BAZA LIGJORE	5
1. QËLLIMI DHE NEVOJA PËR RISHIKIM TË DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT	7
2. DOKUMENTET, PJESË E PPV, TË CILAT DO TI NËNSHTROHEN RISHIKIMIT	8
3. EKSPERTËT (FUSHAT E EKSPERTIZËS) QË DO TË PËRBËJNË GRUPIN E PUNËS QË DO TË RISHIKOJNË PPV-NË	11
4. PËRCAKTIME PËR PROCESIN E BASHKËRENDIMIT, KËSHILLIMIT DHE TAKIMEVE PUBLIKE	12
5. PLANI I VEPRIMIT PËR RISHIKIMIN E DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT.....	13
6. PEZULLIMI I ZHVILLIMEVE NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË	14

HYRJE

Bashkia Elbasan ndodhet në Shqipërinë e Mesme. Ajo përbëhet nga 12 Njësi Administrative, respektivisht:

1. Njësia Administrative Bradashesh
2. Njësia Administrative Papër
3. Njësia Administrative Labinot-Fushë
4. Njësia Administrative Labinot-Mal
5. Njësia Administrative Funar
6. Njësia Administrative Shushicë
7. Njësia Administrative Shirgjan
8. Njësia Administrative Tregan
9. Njësia Administrative Gjergjan
10. Njësia Administrative Gjinari
11. Njësia Administrative Gracen
12. Njësia Administrative Zavalinë

Bashkia ka një sipërfaqe prej **872.6 km²** dhe një popullsi prej 283,000 banorë.

Karakteristikat gjeografike/territoriale

Elbasani është qytet në Shqipëri dhe njëherit qendër e Prefekturës dhe rrethit me të njëjtin emër. Qytni i Elbasanit ndodhet në Shqipërinë e Mesme. Ai shtrihet në fushën e Elbasanit, në krahun e djathtë të rrjedhjes së mesme të lumenit Shkumbin, i rrethuar në lindje nga Krasta e Madhe dhe e Vogël, në veri dhe veriperëndim nga kodrat e Ullishtave, në perëndim nga përroi i Zaranikës, në jug kufizohet nga lumi Shkumbin. Në anën perëndimore të qytetit kalon përroi i Zaranikës dhe nga lindja ai i Manazdheries. Elbasani është i vendosur midis gjerësive gjeografike veriore $41^{\circ} 27'$, jugore $40^{\circ} 10'$, lindore $20^{\circ} 34'$ dhe perëndimore $19^{\circ} 03'$ dhe ndodhet në një lartësi mesatare prej 125 m mbi nivelin e detit. Veçoritë klimaterike të kësaj zone janë: dimër i butë e me reshje dhe verë e nxehëtë dhe e thatë.

Karakteristikat historike

Historia e trevat të Elbasanit e ka zanafilën e saj në shekullin II p.e.s. me vendbanimet e hershme ilire. Të dhënat arkeologjike besohet se emri i parë i Elbasanit ka qenë mansius që do të thotë vend-qëndrim shumë arkeologë besojnë se vendburimi më i madh



arkeologjik i qytetit antik mund të jetë në zonë lindore të Elbasanit pranë rrapit të mances për shkak të ngjashmërisë midis emrave dhe rrënojave. Në shekullin II qyteti njihej me emrin Skampius e më vonë me emrin Skampi dhe ishte në varësinë administrative të Durrahut (Durrësit). Duke qenë i vendosur në kryqëzimin e rrugëve Veri Jug dhe Lindje Perëndim, ai ka shërbyer si pikë e rëndësishme kalimi dhe si stacion i rëndësishëm, duke u përmendur si qendër urbane, ushtarake e peshkope. Gjatë periudhës romake Skampius njohu lulëzimin e tij më të madh sepse ishte një kryqëzim rrugësh ku Perandoria Romake ndërtoi rrugën Via Egnatia një rrugë me strategji ushtarake dhe ekonomike ku do lidhej Roma me Kostandinopojën, ku në Skampius kryqëzoheshin dy rruge ajo që vinte nga Dyrrahu dhe Apolonia, ku kjo rrugë e rëndësishme strategjike shërbeu edhe gjatë luftërave fetare kryqëzatat. Pas bllokimit të rrugës Via Egnatia nga dyndjet e barbarëve, qyteti i Skampinit nuk përmendej më dhe u shkatërrua nga bullgarët dhe ostrogotët gjatë migrimit sllavo-bullgar diku nga shekulli VI-VII.

Elbasani u themelua nga Sulltan Mehmeti II dhe Ballaban Pasha në shekullin XV. Iu vu ky emër sepse ishte një ndër trevat e para të pushtuara nga osmanlinjtë, ELI-BASAM (vura dorë). Pas disfatës që pësoi në rrethimin e dytë të Krujës, Sulltan Mehmeti II, rindërtoi në kthim në vitin 1466 kalanë e vjetër, për ta pasur si pikë mbështetje të mëvonshme. Kalaja u ndërtua në vetëm 25 ditë dhe në ndërtimin e saj ndihmuani 150.000 njerëz.

Në hyrje të kalasë, mbi një pllakë, sultani shkroi në turqisht: “Eli-Basan, es Sulltan, ibni Sulltan, Fahati Sulltan, Mehmet thani han.” (Vura dorë, unë sultani bir sultani, sultani triumfues, Mehmeti, mbret i madh.”). Pra, Elbasan do të thotë “vura dorë”.

Me kalimin e kohës rreth Kalasë u zhvillua qyteti i Elbasanit.

Në dokumentacionin e kohës dëshmohet se në mesin e shekullit XVII Elbasani kishte 2000 shtëpi dhe 900 dyqane. Punoheshin lëkura, leshi, mëndafshi, metalet e sidomos argjendi. Pas pushtimit turk Elbasani u shndërrua në qendrën e Islamit në Shqipëri. Për shkak të pozitës shumë të favorshme në rrugën Egnatia, Elbasani u kthye në një qendër tregtë shumë të rëndësishme. Përkrah tregtarëve vendas dhe turq në qytet ishin ngulitur edhe tregtarë grek dhe sllav.

Prodhimet e qytetit të Elbasanit gjenin treg shitjeje si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Këtë e dëshmon fakti që Turqia në dy ekspozita ndërkombëtare, njëra në Paris në vitin 1867 dhe tjetra në Çikago në vitin 1894, krahas artikujve të tjera të artizanatit ekspozoi edhe pushkë, pistoleta dhe silahe të prodhimit shqiptar të Shkodrës, Elbasanit, Prizrenit, etj. E rëndësishme është se Elbasani shquhet për organizimin e panaireve. Panairi i parë është ai i vitit 1381 i pasuar nga të tjera në periudha të mëvonshme.

Në këtë kohë Elbasani shquhet si qendër e fuqishme arsimore dhe kulturore me përpjekjet që bënë Bugomili (anonimi i Elbasanit), Dhaskal Todri për përhapjen e gjuhës e të shkrimit shqip. Në epokën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare zë një vend të



rëndësishëm Kostandin Kristoforidhi, autor i abetares shqipe, fjalorit gegërisht dhe toskërisht, i cili konsiderohet si babai i gjuhës shqipe. Në etapën e fundit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare veçojmë Elbasanin si përhapës të mendimit përparimtar arsimor e kulturor. Pas shpalljes së Hyrjetit, Kushtetutës Xhonturke, u krijuan një sërë shoqërish dhe klubesh nga patriotët elbasanas, të cilët detyrë kryesore kishin përhapjen e gjuhës dhe shkrimit shqip.

Më 2-9 shtator 1909 u thirr Kongresi i Elbasanit ndër vendimet më kryesore të të cilat që hapja e shkollës Normale, e cila u realizua më 1 dhjetor 1909 dhe krijimi i Shoqërisë Përparimi, e cila do të mbështete financiarisht këtë shkollë. Kjo shkollë ka qenë e para shkollë e mesme e arsimit kombëtar shqiptar.

Qyteti i Elbasanit konsiderohet si një nga vratat më të rëndësishme të luftës për liri dhe çlirim kombëtar. Si pika kulmore përmendim aktin e shpalljes së pavarsisë së Elbasanit më 25 Nëntor 1912, si i pari qytet i Shqipërisë, pjesëmarrjen aktive në Luftën e Vlorës në vitin 1920, në Lëvizjen Demokratike Antifeudale të vitit 1921 - 1924, si dhe në Luftën e Dytë Botërore.

Gjatë periudhës 1924 -1939 qyteti i Elbasanit arriti një zhvillim të ndjeshëm në disa drejtime si p.sh. në infrastrukturë kryesisht me ndërtimin e rrugëve që lidhnin Elbasanin me Tiranën, Durrësin, Korçën, Gramshin, Dibrën, etj, ndërtimin e ujësjellësit të qytetit dhe ndërtimin e centralit elektrik. Gjatë kësaj periudhe mori zhvillim edhe ekonomia me ngritjen e disa objekteve si: fabrika e alkoolit, duhan-cigareve, vaj-sapunit duke vazhduar punën artizanale tradicionale. Në këtë kohë kemi ngritjen e degëve të bankave shqiptare dhe të huaja, të cilat nxisin prodhimin bujqësor e industrial të Elbasanit.

Në vitin 1945 në Shqipëri u vendos regjimi komunist. Si të gjithë qytetet e tjera të Shqipërisë edhe Elbasani vuajti për 45 vjet represionin e egër komunist që donte ta privonte qytetin nga prirjet e tij demokratike dhe kulturore. U persekutuan personalitetet më të shquara të qytetit të Elbasanit. U vu dorë mbi institucionet e kultit duke i transformuar sipas "ideologjisë së re". Në proceset demokratikë të vitit 1990 edhe qytetarët e Elbasanit morën pjesë aktive në to. Personalitetet më të shquara të shekullit të kaluar për qytetin e Elbasanit janë: Aqif Pashë Elbasani, Aleksandër Xhuvani, Lef Nasi, Ahmet Dakli, Et'hem Haxhiademi, etj.

BAZA LIGJORE

Bashkia Elbasan kërkon të rishikojë dokumentin e planifikimit për një pjesë të territorit me procedurë të përshpejtuar, sipas përcaktimeve të neneve 11 dhe 12 të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar.



- a. Neni 26, pika 2 e Ligjit Nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, përcakton:

“Planet ndryshohen edhe kur ka ndarje administrative e territoriale, ndryshime të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshime të shkaktuara nga kriza sektoriale apo nga forca madhore, si dhe në rastet kur lind nevoja e harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsyen të përafrimët me legjislacionin e Bashkimit European”.

- b. Neni 11, pika 3 e VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar, përcakton:

“Në disa raste, procesi i rishikimit të dokumentit të planifikimit realizohet duke ndjekur një procedurë të thjeshtuar, e cila ka për qëllim të shkurtojë afatet e procesit të planifikimit, këshillimit e të bashkërendimit, të përjashtojë miratimin e nismës dhe të trajtojë vetëm pjesët e dokumentit të planifikimit, subjekt rishikimi, në varësi të rastit dhe nevojave”.

Procedura e thjeshtuar ndiqet kur rishikimi i dokumentit të planifikimit bëhet për një pjesë të territorit dhe përbushen kriteret e mëposhtme:

- a) Dokumentet e planifikimit ndryshohen për çështje që nuk cënojnë vlerat natyrore e mjedisore, zonat e mbrojtura dhe trashëgiminë historike e kulturore;
- b) Rishikimi nuk shoqërohet me ndryshime të strategjisë territoriale;
- c) sipas pikës 2 të nenit 26 të ligjit.

Referuar nenit 12, pika 1 të VKM Nr. 686/2017, Dokumenti i nismës për hartimin e PPV-së, përmban:

- a) hartimin e dokumentit të Nismës për rishikimin e pjesshëm të dokumentit përkatës të planifikimit, duke specifikuar:

- i. qëllimin dhe nevojën e rishikimit të planit;
 - ii. dokumentet apo pjesët përbërëse të tyre, subjekt rishikimi;
 - iii. ekspertët që do të përbëjnë grupin e punës për rishikimin e dokumentit;
 - iv. përcaktimë për procesin e bashkërendimit, këshillimit dhe takimeve publike duke specifikuar afatet;
 - v. planin e veprimeve për rishikimin e dokumentit;
 - vi. sipas rastit, vendimin për pezullimin e zhvillimit për të gjithë, ose një pjesë të territorit subjekt rishikimi, sipas nenit 33 të Ligjit, shoqëruar me hartën përkatëse.

- b) këshillimin e projekt dokumentit të nismës me Agjencinë dhe publikun nëpërmjet Regjistrat Kombëtar të Planifikimit të Territorit;

- c) botimin e dokumentit përfundimtar të nismës, me reflektimet përkatëse në rast të komenteve, shoqëruar me vendimin e autoritetit përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit për ndërmarrjen e nismës.

Procesi i rishikimit të PPV-së do të bazohet në **Ligin Nr. 107/2014** "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, **VKM Nr. 686, datë 22.11.2017** "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, **Udhëzimin Nr.1 datë 06.12.2021** të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT-së "Për hartimin, bashkërendimin, miratimin edhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të planeve të përgjithshme vendore me procedurë të thjeshtuar", **Udhwzimi Nr. 47, datw 11.05.2022** të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT-së pwr njw shthesn nw Udhëzimin Nr.1 datë 06.12.2021 si dhe legjislacionin sektorial në fuqi.

Po sipas përcaktimeve ligjore, autoriteti përgjegjës për rishikimin e PPV-së është kryetari i Bashkisë. Dokumenti do të hartohe në bashkërendim dhe këshillim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

1. QËLLIMI DHE NEVOJA PËR RISHIKIM TË DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT

Me Vendimin Nr. 1 datë 29.12.2016, Këshilli Kombëtar i Territorit ka miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Elbasan, rishikuar dhe me Vendimin Nr. 2, datë 24.11.2021 të Këshillit Kombëtar të Territorit, rishikuar me Vendimin Nr. 3, date 25.04.2023 të Këshillit Kombëtar të Territorit .

Gjatë periudhës së zbatimit të tij, bashkia ka evidentuar disa vështirësi në zbatimin e këtij dokumenti të listuara si më poshtë:

- a. Gabime materiale apo lapsuse te pasaportave të ndryshme.
- b. Tregues te paaplikueshem ne disa pasaporta.

Arsyet për ndërmarrjen e nismës për rishikimin e Planit, lidhen kryesisht me nevojën e bashkisë për:

Shmangjen e ketyre gabimeve ne pasaporta te ndryshme, me qellim lehtesimin e shqyrtimit te aplikime ne sistemin e-leje.

Mbështetur dhe në rezultatet e analizave të mësipërme, PPV e rishikuar do të zgjidhë problematika që lidhen edhe me te gjitha llojet e lejeve.

Stafi i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit pranë bashkisë Elbasan ka analizuar me vemandje planin dhe ka njoftuar kryetarin e Bashkisë për cështjet e evidentuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, të cilat nevojitet të rishikohen dhe i ka propozuar për rishikimin e këtij plani, me qëllim zhbllokimin e situateve se krijuar ne lidhje me lejet e ndertimit ne Bashkine e Elbasanit.

2. DOKUMENTET, PJESË E PPV, TË CILAT DO TI NËNSHTROHEN RISHIKIMIT

Bazuar në analizën e dokumentit të planifikimit në fuqi si dhe bazuar në sa më sipër, është evidetuar që dokumentet që do të preken nga procesi i rishikimit të PPV janë:

Disa nga Pasaportat e PPV-se.

1. Njësia strukturore 1/1
2. Njësia strukturore 1/3
3. Njësia strukturore 1/24
4. Njësia strukturore 1/25
5. Njësia strukturore 1/30
6. Njësia strukturore 1/35
7. Njësia strukturore 1/38
8. Njësia strukturore 1/39
9. Njësia strukturore 1/44
10. Njësia strukturore 1/45
11. Njësia strukturore 1/48
12. Njësia strukturore 1/49
13. Njësia strukturore 1/50
14. Njësia strukturore 1/51
15. Njësia strukturore 1/54
16. Njësia strukturore 1/56
17. Njësia strukturore 1/57
18. Njësia strukturore 1/58
19. Njësia strukturore 1/59
20. Njësia strukturore 1/60
21. Njësia strukturore 1/60_1
22. Njësia strukturore 1/60_2
23. Njësia strukturore 1/70
24. Njësia strukturore 1/75
25. Njësia strukturore 1/93
26. Njësia strukturore 1/97
27. Njësia strukturore 1/100
28. Njësia strukturore 1/101
29. Njësia strukturore 1/102
30. Njësia strukturore 1/110
31. Njësia strukturore 1/114_1
32. Njësia strukturore 1/123
33. Njësia strukturore 1/132
34. Njësia strukturore 1/135
35. Njësia strukturore 1/137
36. Njësia strukturore 1/138
37. Njësia strukturore 1/140
38. Njësia strukturore 1/141
39. Njësia strukturore 1/144
40. Njësia strukturore 1/146
41. Njësia strukturore 1/149
42. Njësia strukturore 1/161
43. Njësia strukturore 1/167

(11)

44. Njësia strukturore 1/175
45. Njësia strukturore 1/194
46. Njësia strukturore 1/197
47. Njësia strukturore 2/4
48. Njësia strukturore 2/16
49. Njësia strukturore 3/30
50. Njësia strukturore 3/83
51. Njësia strukturore 3/84
52. Njësia strukturore 3/85
53. Njësia strukturore 3/86
54. Njësia strukturore 3/87
55. Njësia strukturore 3/89
56. Njësia strukturore 3/94
57. Njësia strukturore 3/98
58. Njësia strukturore 3/115
59. Njësia strukturore 3/117
60. Njësia strukturore 3/121
61. Njësia strukturore 3/122
62. Njësia strukturore 3/125
63. Njësia strukturore 3/126
64. Njësia strukturore 3/141
65. Njësia strukturore 3/156
66. Njësia strukturore 3/182
67. Njësia strukturore 6/66
68. Njësia strukturore 7/22
69. Njësia strukturore 7/67
70. Njësia strukturore 8/12
71. Njësia strukturore 8/13
72. Njësia strukturore 8/15
73. Njësia strukturore 8/18
74. Njësia strukturore 8/21
75. Njësia strukturore 8/22
76. Njësia strukturore 8/23
77. Njësia strukturore 8/116
78. Njësia strukturore 8/186_1
79. Njësia strukturore 9/22
80. Njësia strukturore 9/32
81. Njësia strukturore 9/33
82. Njësia strukturore 9/35
83. Njësia strukturore 9/43
84. Njësia strukturore 9/44
85. Njësia strukturore 9/78
86. Njësia strukturore 9/111
87. Njësia strukturore 10/1
88. Njësia strukturore 10/16
89. Njësia strukturore 10/27
90. Njësia strukturore 10/40
91. Njësia strukturore 10/65
92. Njësia strukturore 10/97
93. Njësia strukturore 11/24

(12)

94. Njësia strukturore 11/39
95. Njësia strukturore 11/43
96. Njësia strukturore 11/44
97. Njësia strukturore 11/45
98. Njësia strukturore 11/46
99. Njësia strukturore 11/47
100. Njësia strukturore 11/54
101. Njësia strukturore 11/55
102. Njësia strukturore 11/56
103. Njësia strukturore 11/81

KREU II

NJËSI, KU KËRKOHET NDARJE E TYRE DHE NDRYSHIM TREGUESISH SË ZHVILLIMIT

1. Njësia strukturore 1/8_1
2. Njësia strukturore 1/8_2
3. Njësia strukturore 1/9_1
4. Njësia strukturore 1/98
5. Njësia strukturore 1/99
6. Njësia strukturore 1/99_1
7. Njësia strukturore 2/32
8. Njësia strukturore 3/178
9. Njësia strukturore 3/178_1
10. Njësia strukturore 3/181_1
11. Njësia strukturore 3/181_2
12. Njësia strukturore 5/84_1
13. Njësia strukturore 7/24
14. Njësia strukturore 7/25
15. Njësia strukturore 8/186_2
16. Njësia strukturore 9/42_1
17. Njësia strukturore 11/57
18. Njësia strukturore 12/50

KREU III

NJËSI, KU KËRKOHET NDARJE E TYRE PA NDRYSHIM TREGUESISH SË ZHVILLIMIT

1. Njësia strukturore 1/8
2. Njësia strukturore 1/9
3. Njësia strukturore 1/71
4. Njësia strukturore 1/198
5. Njësia strukturore 3/181
6. Njësia strukturore 5/84
7. Njësia strukturore 7/20
8. Njësia strukturore 8/186
9. Njësia strukturore 9/42
10. Njësia strukturore 11/16
11. Njësia strukturore 12/5
12. Njësia strukturore 12/52
13. Njësia strukturore 12/53

KREU IV

NJËSI KU KËRKOHET NDRYSHIM NË TREGUESIT INFRASTRUKTUROR

1. Rruga Teda Fish City Free Zone

2. Rruga Prita e Zaranikës-rruga lidhëse me fshatin Cerrujë
3. Rruga e zonës së re të Varrezave të Qytetit, Njësia strukturore 5/84, Vidhas, Bradashesh
4. Rruga nga rrerhrotullimi i Varrezave Ekzistuese të qytetit-kryqëzimi i rrugës "Nos Josifi", Njësia strukturore 1/126, Lagja "Emin Matraxhiu", Elbasan
5. Rruga Dopaj-Funar, Elbasan
6. Rruga kryqëzimi i rrugës "Qemal Stafa"-AUTOMOTO PARK, Lagja "Emin Matraxhiu", Elbasan

Shtojca 1 Harta e njësive, ku kërkohet ndarje e tyre me ose pa ndryshim treguesish së zhvillimit

Përbajtja e dokumentit të rishikuar të PPV do të bazohet në VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", dhe udhëzimeve të nxjerra nga AKPT, konkretisht do të përbajë:

- *Dokumentin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, ku jepen:*

- b) ndërhyrje në pasaportat e njësive strukturore;*
- c) etj, sipas analizimit të detajuar Planit të Përgjithshëm Vendor.*

- Shtojcat përkatëse;

Dokumentacioni i përgatitur në kuadër të procedurës së rishikimit të PPV këshillohet në mënyrë të vazhdueshme me AKPT, nëpërmjet postës zyrtare dhe elektronike, takimeve dhe në çdo rast nëpërmjet Rregjistrat Kombëtar të Planifikimit të Territorit (RKPT).

3. EKSPERTËT (FUSHAT E EKSPERTIZËS) QË DO TË PËRBËJNË GRUPIN E PUNËS QË DO TË RISHIKOJNË PPV-NË

Përsa i përket organizimit të strukturave të përfshira në procesin e rishikimit të PPV-së, dokument i rishikimit të PPV do të hartohet nga stafi i Bashkisë në bashkërendim dhe bashkëpunim me stafin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

Stafi i Bashkisë, i cili do të angazhohet në rishikimin e dokumentit të PPV, përbëhet nga ekspertë të fushave:

- Të planifikimit të territorit;
- Të informacionit gjeohapësinor;
- Të mjedisit;
- Të fushës juridike, të specializuar në çështje të planifikimit të territorit.

Grupi i punës listohet si më poshtë:

Zëvendëskryetar: Asim Sula

Koordinator i Zhvillimit Urban: Alba Canaj

14

Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikim-Zhvillimit Urban dhe Shërbimeve Infrastrukturore (DPPZHUSHI): Dritan Meta

Drejtor, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT): Ariola Muhametaj

Përgjegjës, Sektori i Kontrollit të Lejeve (DPZHT): Metjon Musmuça
Përgjegjës,

Sektori i Kushteve Tekniko-Ligjore, Planifikimit dhe Zbatimit të Infrastrukturës në Territor (DPZHT): Sokol Radoniqi

Jurist, Sektori i Kushteve Tekniko-Ligjore, Planifikimit dhe Zbatimit të Infrastrukturës në Territor (DPZHT): Denis Hasa

Planifikues Urban, Sektori i Kushteve Tekniko-Ligjore, Planifikimit dhe Zbatimit të Infrastrukturës në Territor (DPZHT): Anamaria Gjoshi

Drejtor, Drejtoria e Projektimit (DP): Marvis Avllazagaj Përgjegjës,

Sektori Topografik (DP): Gentiana Kërrri

Drejtor, Drejtoria e Transportit Publik: Eduard Bordi (Përgjegjës)

Grupi i punës do të marrë në konsideratë kërkesat e ardhura në adresë të Bashkisë, të cilat lidhen me zbatimin e PPV-se, do të shqyrtojë dhe do të propozojë rishikimin e mospërputhjeve midis pjesëve të ndryshme të PPV-së si dhe do të përgatisë relacionet përkatëse.

4. PËRCAKTIME PËR PROCESIN E BASHKËRENDIMIT, KËSHILLIMIT DHE TAKIMEVE PUBLIKE

Gjatë hartimit të dokumentit të rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor është tepër e rëndësishme të sigurohet një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndërmjet autoriteteve qeverisëse dhe komunitetit, me synim harmonizimin e trajtimit të çështjeve të rëndësishë vendore, të hasura gjatë periudhës së zbatimit të PPV-së.

Sipas përcakttimeve të VKM Nr. 686/2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, bashkërendimi dhe këshillimi i PPV-së është përgjegjësi e njësisë së qeverisjes vendore dhe parashikohet të kryhet një takim publik me grupet e interesit.

Gjatë procesit të rishikimit të PPV, nga grupi i punës në bashkëpunim me AKPT do të vlerësohet:

- a. *Nevoja për konsultim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), për detyrimin ose jo të ndjekes së procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor.*
- b. *Nevoja për bashkërendim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) për ndryshime që mund të propozohen në zonat e banuara brenda Zonave të Mbrojtura.*

- c. Nevoja për bashkërendim me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore për ndryshime që mund të jenë në afërsi të monumenteve.
- d. Nevoja për bashkërendim me Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe Hekurudhën Shqiptare për ndërhyrje që mund të jenë në afërsi të rrugëve nacionale dhe rrjetit hekurudhor.
- e. Nevoja për bashkërendim me institucione të tjera publike, sipas propozimeve të bashkisë.

Grupi i punës do të analizojë dhe rishikojë çdo kërkesë të ardhur pranë Bashkisë Elbasan.

Komentet dhe propozimet e takimeve publike do të reflektohen dhe do t'i bashkëlidhen dokumentit të planifikimit.

5. PLANI I VEPRIMIT PËR RISHIKIMIN E DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT

Pas ndërmarrjes së nismës për rishikimin e PPV-së do të bëhet njoftimi i palëve të interesuara. Projekt-dokumenti i Nismës dhe Nisma e miratuar nga Kryetari do të botohen në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit (RKPT) dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit.

Hapat më kryesorë janë si më poshtë:

- a. Bashkia do të sigurojë një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi, horizontal e vertikal, me çdo autoritet të planifikimit e palë të interesuar, përpara fillimit dhe gjatë procesit dhe gjatë rishikimit të PPV-së.
- b. Bashkia do të këshillohet me AKPT-në dhe palët e interesuara. Bashkia i vë në dijeni rregullisht të interesuarit për ecurinë e procesit, nëpërmjet botimeve në regjistër;
- c. Vendimi i Kryetarit të Bashkisë, përgjegjës për marrjen e nismës, botahet në RKPT, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së nismës, sipas përcaktiveve të Ligjit Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar.
- d. Vendimi i Kryetarit për marrjen e nismës bëhet publik edhe në faqen zyrtare të bashkisë.
- e. Bashkërendimi dhe këshillimi kryhet përmes botimit të dokumenteve në regjistër, informimit të palëve të interesuara dhe publikut nëpërmjet një a më shumë mjeteve tradicionale të informimit dhe përmes organizimit të takimeve publike me ta.

6. PEZULLIMI I ZHVILLIMEVE NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË

Referuar nenit 33 të Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, bashkisë i rezervohet e drejta, që sipas rastit, me vendim të Kryetarit të Bashkisë të pezullojë zhvillimet për të gjithë, ose një pjesë të territorit subjekt rishikimi.

Konkretnisht, gjatë procesit të rishikimit të dokumentit të planifikimit të territorit të saj administrativ, bashkia **propozon** të zbatohet instrumenti i pezullimit të zhvillimeve në territor, per te gjitha ato njesi strukturore, pjesë te rishikimit te PPV-se.



740
05.07.2024



REPUBLIKA SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 2442/2 Prot

Elbasan më 03.07.2024

VENDIM

Nr. 59, Datë 10.06.2024

“Për dhënie pëlqimi për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin me ujë të pijshëm dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura”

Mbështetur në ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 10.06.2024, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a, mbi gjenden e shoqërisë dhe propozimin e saj për rishikimin e tarifave të ujit të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura, bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” Nenet 8, 9, 23, 54, ligjin 8102 datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të përpunimit të ujërave të ndotura” i ndryshuar, VKM 63 datë 27.01.2016 “Për ri organizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”

VENDOSI

1. Dhënie pëlqimi për miratimin e nivelit të ri të tarifave për ofrimin e shërbimit të ujit të pijshëm dhe të largimit të ujërave të ndotura, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Ky vendim duhet ti përcillet Entit Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimin të ujërave të ndotura për miratimin e tarifave.
3. Ngarkohet Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konc: D. Tregtare: M. Çala

D. Teknik: J. Doci

Miratoi: Ç. Leka

SEKRETARI

Elvi Çuni

Adresa: Bashkia Elbasan", Tel +355 54 0152, E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al ëeb: www.elbasani.gov.al

KRYETARI

Lutfi Lala





Emertimi	Tarifë fikse	Tarifë variabël
I. Konsumatorë me matës		
Për grumbullimin, përpunimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik (Kategoria A&B e licencës)	Lekë/klient/muaj	Lekë / m ³
Konsumatorë familjarë	200	60
Ente publike	400	130
Ente private	400	130
Shitje ujë me shumicë		
Për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura (Kategoria C e licencës)	Lekë/klient/muaj	Lekë / m ³
Konsumatorë familjarë	0	15
Ente Publike	0	30
Ente private	0	30
Për shërbimin e përpunimit të ujërave të ndotura (Kategoria D e licencës)	Lekë/klient/muaj	Lekë / m ³
Konsumatorë Familjarë	0	0
Ente publike	0	0
Ente private	0	0
Për shërbimin e largimit e përpunimin e ujërave të ndotura (nëse tarifat do të janë për të dy shërbimet) (Kategoria C&D e licencës)	Lekë/klient/muaj	Lekë / m ³
Konsumatorë Familjarë	0	0
Ente publike	0	0
Ente private	0	0
II. Konsumatorë familjarë pa matës		
A. Pagesë për frysme* (sipas normatives konsumit përfrymë)	60	Lekë/ m ³ x normativa konsumit x nr.personave në familje
B . Pagesë fikse mujore (tarife flete)	Lekë/muaj/familje	
Për grumbullimin, përpunimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik (Kategoria A&B e licencës)		
Për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura (Kategoria C e licencës)		
Për shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura (Kategoria D e licencës)		
Për shërbimin e largimit e përpunimit të ujërave të ndotura(nëse tarifat do të janë për të dy shërbimet) (Kategoria C&D e licencës)		

Adresa: Bashkia Elbasan", Tel +355 54 0152, E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al ëeb: [ëeb: elbasani.gov.al](http://www.elbasani.gov.al)



2442/3
16.07.2024.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 748/
1

Elbasan më 15.07.2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, pas verifikimit të ligjshmërisë së akitit tuaj nr.59 datë 10.06.2024 “Për dhënie pëlqimi për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin me ujë të pijshëm dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Në mungesë dhe me urdhër

NËNPREFEKTI I GRAMSHIT

